



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:254702  
Datë: 03.10.2024  
Numri i dokumentit: 06249293

**K.DH.Shk II.nr.1620/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbarimore të kreditorit “TEB” SH.A., me seli ne zyrën Qendrore në Prishtinë, me adresë në rrugën ”Agim Ramadani” nr.15, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson “Debt Loan Recovery” SH.P.K. në Prishtinë, ndaj debitorëve “New Design” SH.P.K., me numër të biznesit 70847086, me adresë në rrugën “Bill Clinton”, ndërtesa “Hidroekonomia“ i përfaqësuar nga S.G. (kredimarrës), V.G. me adresë rr.”Arbrija” nr.20 në Fushë Kosovë si (bashkëkredimarrës), N.SH. “Nika Shped” me numër të.biznesit 70240996, rruga ”Shelgjet” Çagllavicë përfaqësuar nga RR.N. (garantues) dhe RR.N. (garantues), me adresë ne fshati “Gllanasellë” Komuna e Drenasit, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1889/23 të datës 19.04.2024, me datë **02.10.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit “TEB” SH.A., me seli ne zyrën Qendrore në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1889/23 të datës 19.04.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.1889/23 të datës 19.04.2024, ne dispozitiv të aktvendimit ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorëve “New Design” SH.P.K., V.G., N.SH. “Nika

Shped” dhe RR.N., dhe Urdhri Përbarimor P.nr. 7/17 i datës 18.01.2017 i lejuar nga Përbaruesi Privat Sefer Sh. Arifi, është shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë kreditori (*me pretendime sikur në ankesë*) duke kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të anuloj vendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1889/23 të datës 19.04.2024, dhe të bie vendim që edhe njëherë të shqyrtohet lënda në gjykatë. Mbi arsyet e lartcekura ka kërkuar nga gjykata të vendos si në propozimin e lartpërmendur.

**- Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “TEB” SH.A. ka lëshuar Urdhrin Përbarimor P.nr. 7/17 të datës 18.01.2017, me të cilin e ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit përbarues Marrëveshja mbi Pengun Nr.26646 së Mbitërheqjes së Mundësuar Shtojca 1) Marrëveshja mbi Pengun me Nr.26646, duke detyruar debitorin që t’ia paguaj kreditorit shumën prej 17,028.00€ (shtatëmbëdhjetë mijë e njëzet e tetë euro) si dhe shpenzimet dhe tarifat e procedurës përbarimore në të kundërtën realizimi i përbarimit do të bëhet me sekuestrimin e mallit të specifikuar në listën e pengut Nr.26646 të datës 06.02.2013 si dhe automjetet në listën e pengut me Nr.26646 të datës 06.02.2013.

Debitorët brenda afatit ligjor kanë paraqitur prapësim duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përbarimit me pretendimin se kanë arritur marrëveshje tek një përbarues tjetër privat për shlyerjen e borxhit dhe se konform kësaj marrëveshjeje është duke bërë shlyerjen e borxhit. Gjykatës i kanë propozuar që prapësimin e debitorëve ta aprovojnë në tërësi si të bazuar .

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorëve si të pabazuara. Lidhur me pretendimin e debitorëve për arritjen e marrëveshjes kreditori ka theksuar se meqenëse debitorët nuk e kanë respektuar marrëveshjen lënda është tërhequr nga përbaruesi privat paraprak. Gjykatës i ka propozuar që të hudhet poshtë si i pabazuar kundërshtimi i debitorëve dhe të vazhdoj procedura përbarimore konform urdhrit për përbarim.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimit, përgjigjes në prapësim dhe shkresave në lëndë, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1889/23 të datës 19.04.2024, me të cilin në dispozitiv të aktvendimit ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorëve “Neë Design” SH.P.K., V.G., N.SH. “Nika Shped” dhe RR.N., dhe Urdhri Përbarimor P.nr. 7/17 i datës 18.01.2017 i lejuar nga Përbaruesi Privat Sefer Sh. Arifi, është shfuqizuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar se dokumenti, përkatësisht Marrëveshja mbi Pengun Nr.26646 së Mbitërheqjes së Mundësuar Shtojca 1) Marrëveshja mbi Pengun me Nr.26646, e mbi bazën e së cilës është paraqitur propozimi për përmbarrim nga ana e kreditorit dhe është lejuar urdhri përmbarrimor nga ana e përmbarruesit privat, nuk është deponuar në origjinale apo kopje të vërtetuara siç kërkohet me nenin 38 të LPP-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marrë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se baza juridike për caktimin e përmbarrimit, kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të caktuar përmbarrimin sipas dokumentit të përmbarrimit, parashihen sipas dispozitës së nenit 22 par.1 nën par 1.7 dhe me nenin 5 par.2 i Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, nr.05/L-118 të, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore ku në mesin e dokumenteve përmbarrimore në bazë të cilave organi përmbarrues mund të caktoj përmbarrimin është kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit si dhe edhe kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.

Sipas nenit 27, paragrafi 1 të LPP-së, është përcaktuar se *“Dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbarrjes së detyrimit”*. Tutje, sipas nenit 38, paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, *Propozimi për përmbarrim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarrimi, kërkuesi i përmbarrimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarrimi, objekti i përmbarrimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit. 2. Në rast se propozimi për përmbarrim nga paragrafi 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarrues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.*

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejtë se, dokumentet në bazë të cilave është iniciuar procedura përmbarrimore nuk janë në origjinal apo kopje të vërtetuara dhe rrjedhimisht të njëjtat nuk mund të konsiderohen si dokumente të besueshme për përmbarrim në kuptim të dispozitës së lartcekura, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e shkallës së dytë ka analizuar edhe pretendimet tjera të kreditorit por të njëjta mbesin vetëm në natyrën deklarative dhe të pambështetura në prova konkrete siç parasheh dispozita 69 par.4 të LPP dhe si të tilla nuk janë relevante për vendosje ndryshe prandaj kanë rezultuar si të pathemelta të cilat gjykata ankimore vendosi të refuzojë ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi ta vërtetojë.

Përndryshe, në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e shkallës së dytë**  
**K.DH.SH.II nr.1620/24 me datë 02.10.2024**

**Gjyqtari,**  
**Faton Bajrami**